

## AKT THEMELIMI

Sot ne dt.20/11/2023 me cilesine e "Ortakut te Vetem Themelues ",

**AFRIM MALIQI** i datelindjes 05/05/1969, i lindur ne Hajkobille,Kosove dhe banues ne Miradi e Epërme 4 Fushe Kosovë-Kosovë,shtetas kosovar, madhor dhe me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet pasaportes nderkombetare me nr. PO1828661,leshuar nga MPB Kosove ne date 11/03/2021,i cila me vullnet të lire të plete e të sinqerte, dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin "Per Qendren Kombetare te Biznesit", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me perjegjesi të kufizuar, me emertimin **AM SALES shpk.**

### KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

#### Neni 1

#### Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **AM SALES shpk.** Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar.Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

#### Neni 2

#### Forma Juridike

Shoqeria **AM SALES** shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me perjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria **AM SALES** shpk, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaku i vetem që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

#### Neni 3

#### Selia

#### Shoqeria e ka seline ne adresen:

**Tirane,Rruga"Don Bosko",hyrja 5,ap.20 nr.pasurise 9/438+5-20,zk 8330**

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakut te vetem.

#### Neni 4

#### Objekti i veprimtarise

- Importin , eksportin dhe tregetimin me shumice dhe pakice te artikujve te ndyshem industriale , ushqimore , produkteve te ndryshme bujqesore , blegtorale e fruta perime , prodhimeve te detit , pije freskuese , te miellit e nenprodukteve te tij , te konfeksioneve e veshmbathjeve , pajisje elektroshtepiake ,kompjutera dhe pjeset e tjera te tyre , produkte higjenosanitare , hidraulike , prodhime qeramike artizanati, duralumini , mekanike te lendet drusore te perpunuar dhe te paperpunuar,produkteve per ngrohje pellet, lekures e nenprodukteve te saj , mobiljeve dhe materialeve te lendeve te para te te gjitha llojeve , materiale dhe lendeve te ndertimit , pllakat e llojeve dhe dimensioneve te ndryshme , materialeve plastike e nenprodukteve te tyre.**

Neni 5  
Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB).

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000 lekë.

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 leke i perbere nga 1 kuote dhe zoterohet nga ortaku i vetem i shoqerise **AFRIM MALIQI**

Vlera totale e Kapitalit te Regjistruar eshte **100.000 Leke**

Vlera Totale e Kapitalit prej **100.000 Leke** do te paguhet ne te ardhmen nga ortaku themelues.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaku i vetem themelues per gjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakut te vetem.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organë Vendimmarres

Asambleja e Ortakut te vetem themelues eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise. Asambleja e Ortakut te vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modalitetave te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Ortakut te vetem brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit finanziar, miraton reportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

Neni 9

Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator i vetem.

**AFRIM MALIQI** i datelindjes 05/05/1969, i lindur ne Hajkobile,Kosove dhe banues ne Miradi e Epërme 4 Fushe Kosovë-Kosovë,shtetas kosovar, madhor dhe me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet pasaportes nderkombetare me nr. PO1828661,leshuar nga MPB Kosove ne date 11/03/2021.

Emerimi i administratorit eshte me nje afat pese vjeçar me te drejte riemerimi, i cili ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e themelimit te shoqerise te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se ortakut te vetem te shoqerise.



Neni 10  
Kompetencat

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rr Ethanat me përashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Asamblese se ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injororin këtë akt në rr Ethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratori ose ortaku që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të jasin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 11  
Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per çfaredo shkaku, edhe para plotesimit të afatit per të cilin eshte krijuar siç mund të jene

a.Humbja e kapitalit ose pamundesa e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.

b.Ne nje nga menyrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin"

c.Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Ortakut te vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 13  
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil , Ligji per QKB, dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 14

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne tre ekzemclare me permbajtje dhe vlera te njejtë juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i vetem themelues i shoqerise tregtare **AM SALES** shpk, nenshkruehet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISE**